



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .09.2024

MBLEDHJA Nr. 34,
Datë 18.09.2024, ora 12:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 18.09.2024, ora 12:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 34 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 12.09.2024.
2. Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025-2027.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të paluajtshme të saj.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e asioneve të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW, i ndryshuar.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI